



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 4718/11 Prot. Datë 14.7.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 13723/11 Prot. Datë 22.7.2022

UDHËZIM I PËBASHKËT

Nr. 19, datë 14.7.2022

**PËR
ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE TË
MATURËS SHTETËRORE 2022 DHE MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2022**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "a", të pikës 2 të nenit 26 dhe nenit 51 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZIM:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2022, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|-----------------------------|----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 25 gusht 2022 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 30 gusht 2022 |
| c) Matematikë | 2 shtator 2022 |
| ç) Provimi me zgjedhje | 7 shtator 2022 |

2. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni i dytë, të jenë:

- | | |
|--|----------------|
| a) Gjuhë e huaj | 25 gusht 2022 |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 30 gusht 2022 |
| c) Matematikë | 2 shtator 2022 |
| d) Provimi i teorisë profesionale të integruar | 7 shtator 2022 |

3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2022 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni dytë, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore.
4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2022 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni i dytë:
 - a) Fillojnë në orën 10:00.
 - b) Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.
 - c) Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2022 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:
 - a) Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2022 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni i parë.
 - b) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2021-2022 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 16 gusht 2022.
 - c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2021, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2022.
 - ç) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, që kanë të njësuar dokumentet shkollore nga QSHA dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2022.
6. Kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar/zyra vendore e arsimit parauniversitar (këtu e në vijim DRAP/ZVAP) në vendbanimet e tyre.
7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “b”, “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi, të plotësojnë Formularin AIZ, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2022, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë. Këta kandidatë të plotësojnë Formularin AIZ, në datat 17-19 gusht 2022.
8. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar të dërgojë zyrtarisht në ZVAP, listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2022 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni i dytë, deri më datë 18 gusht 2022. Drejtori i ZVAP, ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 18 gusht 2022.
9. Provimet të zhvillohen të përqendruara në ZVAP. ZVAP-et, të përcaktojnë qendrat dhe mjediset ku maturantët/kandidatët do të zhvillojnë provimin, duke mundësuar përqendrimin e tyre sipas kushteve dhe numrit të maturantëve/kandidatëve.
10. ZVAP-et dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare, të marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, qendrën dhe orën kur do të zhvillohet secili

nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2022 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni i dytë.

11. Drejtori i ZVAP-it, brenda datës 16 gusht 2022, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2022, sesioni i dytë, dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2022 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni i dytë. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar njofton për këto qendra dhe mjedise Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS).
12. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2022 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MAS-it dhe të institucioneve të varësisë.
13. Shpenzimet e përfaqësuesve të MAS-it në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2022 dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2022, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
14. Ngarkohet për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësisimit Profesional, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR

Evis KUSHI



MINISTËR

Shkëlqim IBRAHIMAJ

